



KOMUNIKATË

8.12.2009

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e sotshme shqyrtoi aktivitetet e ndryshme që determinojnë procesin e zgjedhjeve. Kryetarja e KQZ-së znj. Nesrin Lushta, pas miratimit të rendit të ditës, i kërkoi Kryeshefit të SKQZ-së z. Xhemajl Peqani, ta informojë KQZ-në me aktivitetet e sekretariatit.

Kryeshefi z. Peqani, tha se fletëvotimet e Raundit të Dytë të Zgjedhjeve për Kryetar të Komunave, deponohen sot dhe se do të jenë të gatshme. Sot poashtu, përfundon faza e fundit e ristrukturimit të stafit për QNR, dhe se ky staf është duke i vijuar trajnimet përgatitore. Janë përgatitur listat përfundimtare nga ZE të KKZ-ve për tërë votuesit me Nevoja te Veqanta në 21 komuna, në të cilat komuna do të mbahen zgjedhjet për Raundin e Dytë dhe për këtë janë planifikuar 75 ekiye mobile për tri kategoritë.

Kryeshefi z. Peqani, informoi lidhur me vulat për vulosjen e FLV-e. Vulat, janë sjellë në depo e SKQZ-së nëpërmjet Aeroportit të Prishtinës nga Kopenhaga dhe, gjendet në dhomën e sigurisë në depo. Më së largu deri të enjten, do të bëhet alokimi i kutive të votimit të Raundit të Parë të Zgjedhjeve për kryetarët e komunave në depon e SKQZ-se, në mënyrë që t'u lirohet vendi kutive të votimit për raundin e dytë.

Sot, materiali zgjedhor jo sensitiv përmes 11 kamionëve, do të shpërndahet në të gjitha komunat që do të ketë balotazh, ndërsa materiali sensitiv do shpërndahet me 11.12.2009 nëpër komuna me përcjellje të policisë së Kosovës. Në momentin kur do të emërohen KVV-të nga ana e KQZ-së, do të filloj edhe trajnimi rifreskues për Kryesuesit e KVV-ve dhe trajnimi i rregullt për KVV-të të marrura rishtazi nga Subjektet Politike.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, është informuar se, një delegacion i KQZ-së nga Shqipëria në përbërje prej katër anëtarëve, ka bërë kërkesë në KQZ që ti vëzhgoj Zgjedhjet e 13 dhjetorit për Raundin e Dytë të Kryetarëve të Komunave në Kosovë.

Në mbledhjen e sotshme të KQZ-së, Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPP-së, i ka paraqitur KQZ-së rekomandimet për akreditim të vëzhguesëve për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve që do të mbahen më 13 dhjetor për Kryetar të Komunave. ZRPP, deri më 07 dhjetor 2009, ka procesuar aplikacionet e vëzhguesve shtesë për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve të katër (4) subjekteve politike (AAK: 235 vëzhgues, LDK: 62 vëzhgues, PDK: 394, Refki Suma: 33 vëzhgues), të dy (2) Organizatave Ndërkombëtare (ENEMO: 116 vëzhgues, ICO: 7 vëzhgues) dhe të tri (3) Ambasadave (Ambasada amerikane me 3 vëzhgues, Ambasada austriake me 1 vëzhgues). Raporti përmban rekomandimin për akreditim të gjithsej, 856 vëzhguesve. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka miratuar rekomandimet për akreditimin e këtyre vëzhguesëve.